



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURENCËS-
KOMISIONI I KONKURENCËS**

VENDIM

Nr.182 , Datë 29.03.2011

“Për

një ndryshim në Vendimin Nr. 156, datë 28.10.2010 “Për miratimin e hapjes së procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të vajit vegjetal” (I ndryshuar)

Komisioni i Konkurrencës, me pjesëmarrjen e:

- Lindita MILO (LATI) Kryetar
- Servete GRUDA Anëtar
- Koço BROKA Anëtar
- Rezana KONOMI Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 24.03.2011, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Zgjatja e periudhës së hetimit paraprak në tregun e importit, dhe tregtimit me shumicë të vajit vegjetal dhe i afatit për përfundimin e hetimit.

Baza ligjore: - Neni 24, shkronja d); neni 42, pika 1, të Ligjit nr. 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (të ndryshuar);
- Ligji Nr. 8485, datë 11. 11. 1999 “Kodi i Procedurave Administrative”;

Komisioni i Konkurrencës pas shqyrtimit të raportit “Mbi hetimin paraprak në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të vajit vegjetal” të paraqitur nga Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës, dhe relacionit përkatës të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës,

VËREN SE:

1. Me anë të Vendimit Nr. 156, datë 28.10.2010 “Për miratimin e hapjes së procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të vajit vegjetal”, ndryshuar me Vendimin e Komisionit të Konkurrencës nr. 173, datë 17.01.2011 “Për një ndryshim në Vendimin Nr. 156, datë 28.10.2010 “Për miratimin e hapjes së procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të vajit vegjetal”, Komisioni i Konkurrencës, në zbatim të nenit 42, pika 1, të Ligjit nr. 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës” (të ndryshuar), ka miratuar hapjen e

procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit, prodhimit dhe tregtimit me shumicë të vajit vegjetal, për të parë nëse kushtet e tregut sigurojnë konkurrencë të lirë dhe efektive.

2. Në zbatim të vendimit të mësipërm, Sekretari i Përgjithshëm i Autoritetit të Konkurrencës ka ndjekur procedurat hetimore të parashikuara në Ligjin 9121 dhe aktet nënligjore përkatëse, si dhe ka përgatitur raportin e hetimit paraprak në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të vajit vegjetal brenda afatit kohor të përcaktuar në vendimin e Komisionit të Konkurrencës.
3. Gjatë shqyrtimit të raportit të hetimit paraprak u vu re se që nga muaji shtator 2010 e në vazhdim tendenca e çmimit të vajit vegjetal ka qenë në rritje, periudhë kjo e cila nuk është e përfshirë plotësisht në hetim. Komisioni e sheh të nevojshme vazhdimin e hetimit, duke marrë në shqyrtim edhe këtë periudhë. Kjo do të çonte në një vlerësim më të plotë të konkurrencës në tregun nën hetim.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në mbështetje të nenit 24, shkronja d), nenit 42, pika 1, të Ligjit nr. 9121 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si dhe Ligjit Nr. 8485, datë 11. 11. 1999 “Kodi i Procedurave Administrative”,

VENDOSI:

1. Në Vendimin Nr. 156, datë 28.10.2010 “Për miratimin e hapjes së procedurës së hetimit paraprak në tregun e importit dhe tregtimit me shumicë të vajit vegjetal”, pika 2 dhe 3, ndryshohen si vijon:
“2. Periudha e hetimit do të jetë nga janari 2008 deri më 31 dhjetor 2010.”
“3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për ndjekjen e procedurave hetimore të parashikuara në Ligj dhe aktet nënligjore, si dhe përgatitjen e raportit të hetimit paraprak, jo më vonë se data 30 maj 2011”
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURENCËS

Servete Gruda

Koço Broka

Rezana Konomi

(_____)
Anëtare

(_____)
Anëtar

(_____)
Anëtare

Lindita Milo (Lati)

K R Y E T A R